

VENDIM
Nr.769, datë 14.11.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË
QYTETIT, NË BASHKINË E PUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave të qytetit, në bashkinë e Pukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Pukës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2250 m² tokë/arë, vlerësuar me çmimin 320 lekë/m², me vlerë të përgjithshme 712 000 (shtatëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Pukës.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Pukës.
 6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë data 30.11.2007.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për objektin “Zgjerimi i varrezave publike të qytetit”, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Pukës, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2 250 m² tokë/arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Pukës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe kryetari i bashkisë së Pukës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE

Puke, me 15.06. 2007

Lista e pronareve te pasurise prone private per te cilet kerkohet shpronnesimi I tokes truall per varrezat e qytetit Puke

Ministrise se Brendshme

TIRANE

Nr	PRONARI	Adresa e Pronareve	Sip. Tokes per Shpronnesim ne m ²	Çmimi Tokes m ² /Leke	Vlera Tokes Per Shpronnesim ne Leke
1.	Halil Mus Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	1155	320	369 600
2	Sherif Osman Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	892	320	285 440
3	Hamit Kapllan Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	178	320	56 960
	SHUMA		2225	320	712 000

V.O. – Pronare, pasurite private te te cileve zhvleresohen per shkak te shpronnesimit te tokes per varrezat e qytetit , nuk ka.

- Pronare te trete qe duhet te kompesohen per shkak te shpronnesimit te tokes per varrezat e qytetit nuk ka.

